



DEKLARATË PUBLIKE

SIGURIA DHE MBROJTJA E FËMIJËVE NUK ËSHTË ZGJEDHJE, POR DETYRIM PËR AUTORITETET VENDORE DHE KOMBËTARE NË SHQIPËRI

Tiranë, 4 Maj 2026 - Organizatat e shoqërisë civile, pjesë e kësaj deklarate, shprehin dhimbjen dhe solidaritetin e tyre me familjet dhe komunitetin e prekur nga humbja tragjike e jetëve të dy fëmijëve në Durrës, të cilët po luanin përpara shtëpisë së tyre, kur u goditën për vdekje nga një makinë. Një fëmijë tjetër është ende duke luftuar për jetën në spital. Kjo ngjarje e rëndë nuk mund të konsiderohet thjesht një "aksidenti i radhës". Ajo është një tronditje e thellë shoqërore që kërkon reflektim urgjent dhe veprime të menjëhershme institucionale.

Kjo tragjedi nxorri në pah pasigurinë me të cilën fëmijët tanë përballen çdo ditë në hapësirat publike. Humbja e jetëve të fëmijëve është pasojë e drejtpërdrejtë e një vargu dështimesh: mungesës së masave parandaluese, planifikimit urban të mangët, neglizhencës në zbatimin e standardeve të sigurisë publike dhe komuniteteve tona jo ekzigjente që nuk reagojnë edhe kur rreziqet prekin më të pambrojturit. Qytetet tona nuk mund të konsiderohen të sigurt nëse hapësirat rekreative të fëmijëve sakrifikohen për hir të ndërtimit intensiv dhe zhvillimit të pakontrolluar. E drejta e fëmijëve për të luajtur dhe zhvilluar jetën e tyre në mjedise të mbrojtura nuk mund të mbetet dytësore.

Përtej mungesës dhe mangësive që infrastruktura për fëmijët ka në çdo Bashki të Shqipërisë, kjo ngjarje dëshmon edhe për një krizë të thellë të përgjegjshmërisë individuale. Kultura e drejtimit të mjeteve në gjendje të dehur dhe mungesa e ndëshkueshmërisë rigoroze ndaj shkelësve të rregullave të qarkullimit, prej kohësh i kanë shndërruar lagjet tona në zona rreziku dhe aksidentesh. Jo më larg se një muaj më parë, një fëmijë në situatë rruge humbi jetën pasi u aksidentua nga dy makina teksa lypte për bukën e gojës në rrugë.

Siguria e fëmijëve kërkon institucione të forta, që garantojnë zbatimin e rreptë të ligjit për sigurinë rrugore, të kombinuar me masat parandaluese dhe ato edukuese, duke mos lejuar që rruga të kthehet në një vend të tragjedi të paralajmëruara.

Siguria publike është një kusht i panegociueshëm në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Kapitujt 23 dhe 24 të *Acquis* kërkojnë qartësisht marrjen e masave nga autoritetet publike për parandalimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e grupeve më vulnerabël. Çdo dështim në këtë drejtim është tregues për mospërmbushjen e standardeve të BE-së nga Shqipëria. Nisur nga kjo ngjarje e shumë të tjera para saj, ne i bëjmë këto rekomandime autoriteteve publike:

- **Forcimin e menjëhershëm të politikave të sigurisë publike dhe rrugore**, duke vendosur mbrojtjen e jetës së fëmijëve si prioritet absolut në çdo planifikim dhe masë.
- **Monitorim 24 orësh të hapësirave publike**, rrugëve dytësore dhe këndeve të lojërave, për të eliminuar çdo rrezik potencial që mund t'ju kanoset fëmijëve.
- **Zbatimin e standardeve strikte urbane**, ku dhënia e lejeve të ndërtimit duhet të kushtëzohet me krijimin e hapësirave të gjelbra, rekreative dhe të sigurta për fëmijët dhe komunitetin.
- **Rritjen e kontrollit dhe ndëshkueshmërisë për drejtuesit e papërgjegjshëm të mjeteve**, duke garantuar që zonat e banuara dhe rrugët pranë shkollave të jenë mjedise me rrezik zero për këmbësorët.
- **Bashkëpunim ndërinstytucional produktiv** (bashki, polici, shërbime sociale, planifikim urban) për të kaluar nga reagimi pas tragjedisë drejt parandalimit aktiv të riskut.

Asnjë fëmijë nuk duhet të humbasë jetën për shkak të neglizhencës, papërgjegjshmërisë apo dështimit institucional. Siguria e tyre është pasqyra më e qartë e përgjegjshmërisë sonë si shtet dhe si shoqëri demokratike.



PUBLIC STATEMENT

THE SAFETY AND PROTECTION OF CHILDREN IS NOT A CHOICE, BUT AN OBLIGATION FOR LOCAL AND NATIONAL AUTHORITIES IN ALBANIA

Tirana, May 4, 2026 – Civil society organizations, signatories of this statement, express their deep sorrow and solidarity with the families and the community affected by the tragic loss of the lives of two children in Durrës, who were playing in front of their home when they were fatally struck by a vehicle. Another child is still fighting for life in the hospital. This grave incident cannot be considered simply “another accident.” It is a profound societal shock that requires urgent reflection and immediate institutional action.

This tragedy exposed the insecurity that our children face every day in public spaces. The loss of children’s lives is a direct consequence of a chain of failures: lack of preventive measures, inadequate urban planning, negligence in enforcing public safety standards, and communities that are not sufficiently demanding and do not react even when risks affect the most vulnerable. Our cities cannot be considered safe if children’s recreational spaces are sacrificed for intensive construction and uncontrolled development. The right of children to play and to grow in safe environments cannot remain secondary.

Beyond the lack and shortcomings of infrastructure for children in every municipality of Albania, this event also reflects a deep crisis of individual accountability. The culture of driving under the influence and the lack of strict enforcement against traffic violations have long turned our neighborhoods into zones of danger and accidents. Just a month ago, a child in a street situation lost his life after being hit by two cars while begging for food on the road.

Child safety requires strong institutions that ensure strict enforcement of road safety laws, combined with preventive and educational measures, so that roads do not become places of predictable tragedies.

Public safety is a non-negotiable condition in Albania’s path toward European Union membership. Chapters 23 and 24 of the Acquis clearly require public authorities to take

measures to prevent risks and protect the most vulnerable groups. Any failure in this regard indicates non-compliance with EU standards by Albania.

Considering this and other similar events, we recommend the following measures to public authorities in Albania:

- Immediate review and strengthening of public and road safety policies, placing the protection of children's lives as an absolute priority in all planning and measures.
- 24-hour monitoring of public spaces, secondary roads, and playgrounds to eliminate any potential risks to children.
- Implementation of strict urban standards, where building permits must be conditional upon the creation of green, recreational, and safe spaces for children and the community.
- Increased control and accountability for irresponsible drivers, ensuring that residential areas and roads near schools are zero-risk environments for pedestrians.
- Effective inter-institutional cooperation (municipalities, police, social services, urban planning) to move from post-tragedy response to active risk prevention.

No child should lose their life due to negligence, irresponsibility, or institutional failure. Their safety is the clearest reflection of our responsibility as a state and as a democratic society.
